



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT  
SEKTORI I ASISTENCËS DHE SHËRBIMIT**

Nr. *6808* Prot.

Tiranë, më / .04.2019

Lënda: Kthim përgjigje

**ZNJ.KOSTANDINA KERUTI**  
**Rr. "Elbasanit", PARK GATE, kati 10, Ap71/73**

**Tiranë**

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 06.03.2019, të dërguar me e-mail në adresën e koordinatores "Për të drejtën e Informimit" në DPT, bazuar në ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e Informimit", regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 110, në të cilën kërkonti disa të dhëna në lidhje me organizatat jofitimprurëse, pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit të sipërcituar, ju informojmë sa më poshtë vijon:

1. Numri i orgazinatave jofirimprurëse të regjistruara gjatë vitit 2018 është: 288 (listën e plotë e gjeni bashkëlidhur, në format elektronik)
2. Numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara në total është: 4.547, nga të cilat 176 janë të çregjistruara (listën e plotë e gjeni bashkëlidhur, në format elektronik)
3. Numri i organizatave jofitimprurëse në status "Pasiv" është: 2.166
4. Numri i organizatave jofitimprurëse me përgjegjësinë tatimore të TVSH-së: 403 (listën e plotë si dhe statusin e kësaj përgjegjësie e gjeni bashkëlidhur, në format elektronik)
5. Numri i punonjësve të punësuar në organizatat jofitimprurëse është: 9.621 (nga informacioni qe disponojmë, nuk kemi të dhëna në lidhje me punonjësit e punësuar me kohë të pjesshme si dhe vullnetarë).
6. Numri total i organizatave jofitimprurëse që kanë qenë objekt kontrolli të plotë gjatë vitit 2018 është: 5

7. Numri i certifikatave të regjistrimit për efekt rimbursimi të TVSH në kuadër të projekteve IPA, financuar nga Bashkimi European, lëshuara nga Administrata Tatimore për vitin 2018 është 11.
8. Numri total i Organizatave Jofitimprurëse me detyrime të papaguara gjatë 30 ditëve është 785, me detyrim 52.632.000 leke.
9. Borxhi total i Organizatave Jofitimprurëse, në datë 18.03.2019, është: 282.315.000 lekë nga 451 organizata.

**ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Xhavit Çurri**



